



Platuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received / Delivered	09.03.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMISHAK	1264/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.55/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtar, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën A.nr.55/2022 të datës 24.01.2022 e parashtruar nga ankuesit dhe

të cilët me autorizim i përfaqëson Avokate me adresë:

Komuna e Vushtrisë, kundër Vendimi KA.nr.66/2021 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.55/2022 e datës 24.01.2022 e parashtruar nga ankuesit

II. SHFUQIZOHET Vendimi KA.nr.66/2021 me numër të protokollit 01/3015 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesit, dhe sipas shkresave të lëndës të punësuar në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në vendin e punës “Zyrtarë të Teknologjisë Informative-IT”, me datë 20.12.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 01/2024 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për: “Kompensimin e shtesave të IT-së në mënyrë retroaktive sipas vendimit KGJK.nr.152/2021 të datës 28.05.2021 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 31.12.2021 me numër të protokollit 01/3015 merr vendimin KA.nr.66/2021 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesve.

Ankuesit, të pa kënaqur me Vendimi KA.nr.66/2021 me numër të protokollit 01/3015 të datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me

datë 24.01.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoli 307/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.01.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 16.02.2022 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/23.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të datës 24.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 31.12.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin më shifër KGJK.nr.152/2021 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 28.05.2021; Vendimin Nr.02/39 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 08.10.2008; Vendimin Nr.07/29 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 08.10.2008; Autorizimin e datës 10.12.2021 për ankuesin [redacted] Akt emërimin e ankuesit [redacted] të datës 29.04.2020; Autorizimin e datës 10.12.2021 për ankuesin [redacted] Akt emërimin e ankueses [redacted] të datës 29.04.2020; Autorizimin e datës 10.12.2021 për ankuesin [redacted] Akt emërimin e ankuesit [redacted] të datës 29.04.2020; Autorizimin e datës 10.12.2021 për ankuesin [redacted] Akt emërimin e ankuesit [redacted] të datës 29.04.2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.01.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 16.02.2022 me numër protokoli:822/2022; kërkesën e ankuesit të datës 20.12.2021 parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; E-mailin e datës 19.08.2021 dërguar nga [redacted] për [redacted] me korrespondencën e bashkangjitur; Listën e pagës për muajin shtator për ankuesit [redacted] dhe [redacted]

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve [redacted] dhe [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesit [redacted] dhe [redacted] sipas shkresave të lëndës të punësuar në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në vendin e punës “Zyrtarë të Teknologjisë Informative-IT”, ndërsa me datë 28.05.2021 Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër KGJK.nr.152/2021 për dhënien e shtesave në pagë për stafin e TI-së të punësuar në KGJK dhe gjykata, kurse në pikën dy (2) të diapozitivit të këtij vendimi është cekur se: “Dhënia e shtesave në pagë për stafin e TI-në KGJK-së dhe gjykatave do të filloj së zbatuari në mënyrë retroaktive nga data e fillimit të punës së tyre”.

Po ashtu, në pikën pesë (5) të diapozitivit të vendimin me numër KGJK.nr.152/2021 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, parashihet që vendimi hynë në fuqi me datë 28.05.2021 ditën kur është nxjerrë, ndërsa Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës me datë 30.05.2021 vendimin në fjalë e ka publikuar në faqen zyrtare elektronike të institucionit, ndërsa në bazë të listës së pagave të ankuesve për muajin shtator të vitit 2021 është vërtetuar se ankuesve në xhirollogarinë e tyre ka filluar t’iu realizohet pagesa në vlerë prej 200 euro në emër të kompensimit për shtesat e IT-së mirëpo jo në mënyra retroaktive, andaj ankuesit me datë 20.12.2021 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me pretendimin dhe kërkesën për pagesën në mënyrë retroaktive të shtesave prej periudhës kur të njëjtit e kanë themeluar marrëdhënien e punës nga data 04.05.2020.

Kolegji, duke u bazuar në dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 që përcakton se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ” si dhe nenin 8 paragrafi 2 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: “Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e



tij nga marrëdhënia e punës”, ka konstatuar se ankuesit ankesën e datës 20.12.2021 e kanë parashtruar jashtë afatit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ngase momenti prej kur ankuesve i është bërë pagesa e shtesës së IT-së në vlerë prej 200 euro në muajin shtator 2021 por jo edhe pagesa në mënyrë retroaktive, kanë kaluar më shumë se tridhjetë (30) ditë.

Po ashtu, Kolegji pas vlerësimit të provat të lëndës ka konstatuar se vendimi KA.nr.66/2021 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datë 31.12.2021 është i paligjshëm siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *”Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: Është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative”* pasi që është përcjell me shkelje procedurale administrative në rastin kur Komisioni e ka shqyrtuar një ankesë e cila është parashtruar jashtë afatit ligjore prej 30 ditësh, andaj si i tillë ky vendim është i paligjshëm dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik dhe i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa mbi këtë bazë ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe si e tillë është refuzuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.66/2021 me numër të protokollit 01/3015 të datës 31.12.2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.55/2022

Flakron GASHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesve, Avokate
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

